



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA GJIROKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

VENDIMI

Nr. 63 datë 04.08.2022

“PËR MIRATIMIN E KËRKESËS SË BASHKISË GJIROKASTËR PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE TË SHPRONËSIMIT PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME PRONË PRIVATE QË DO TË PREKEN PJESËRISHT NGA PROJEKTI I NDRYSHUAR NE REALIZIMIN E INVESTIMIT ME OBJEKT “NDËRTIMI I BYPASS-IT NË QENDRËN HISTORIKE(URA E NANXËS-URAT E MËDHA DUNAVAT)”

Në mbështetje të, Ligjit Nr.139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore”, Ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në dorëzim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”i ndryshuar ,të VKM –së Nr.138 datë 23.03.2000”Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që shpronësohen,të pasurive që zhvlerësohen dhe të drejtave të personave të tretë, për interes publik”e ndryshuar,të VKM-së Nr.658 datë 26.09.2012”Për miratimin e metodologjisë për vlerësimin e pronave të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë”VKM Nr.89 datë 03.02.2019 ,me propozim të Kryetarit të Bashkisë Gjirokastër,

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Bashkisë Gjirokastër për fillimin e procedurave të shpronësimit për pasurinë pronë private që preken pjesërisht nga projekti i ndryshuar në realizimin e investimit me objekt “Ndërtimi i Bypass-it në Qendren Historike(Ura e Nanxes-Urat e Mëdha Dunavat).
2. Pasuria që do të preket nga zgjerimi realizimi i investimit me objekt”Ndërtimi i Bypass-it në Qendren Historike(Ura e Nanxes-Urat e mëdha Dunavat) të qytetit Gjirokastër është si më poshtë:





	Emër Mbiemër	Zk	Nr.pas urisë	Sip Trualli	Sip ndërtimi	Vlera/Cmimi /m ² Trualli Lekë	Vlera/Cmimi/ m ² Ndërtesa Lekë	Vlera e Shpronësi mit
1	Besnik Estref Kotroçi	8542	11/20	115 m ²	20 m ²	4865	47400	1.580.450
2	Drejtoria e Kujdesit Publik	8542	11/23	12 m ²	0 m ²	47400	0	58.380

3. Vlera totale e shpronësimit është 1.638.380 lekë e cila do të përballohet nga buxheti i Bashkisë Gjirokastrë, në zërin “Shpronësim”.
4. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe Drejtoria e Planifikimit ,Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit per zbatimin e vendimit dhe Komisioni i Shpronësimeve pranë Bashkisë Gjirokastrë.
5. Ky vendim hyn në fuqi sipas afateve të përcaktuara në nenin 55 pika 6 të Ligjit Nr.139/2015 “Per veteqeverisjen vendore”.

SEKRETAR I KËSHILLIT

Etleva YZO

KRYETAR I KËSHILLIT

Lavdi HASANI



1/10/19

